




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE: KUNDOR DORËZUAR:		31.10.2022	
DATE: ORIGINALI DOSTAVLJE N:			
DATE: RECEIVED/SUBMITTED:			
Njesia Org. Org. Jed'm. Org. Unit	Sh. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
01	401	2225	2x24



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Prishtinë,
31.10.2022

Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike,
Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Lënda: Dorëzimi i Planit Vjetor të Auditimit për sezonin 2022-23

I/E nderuar,

Në përputhje me nenin 20.2 të Ligjit Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, ju dorëzojmë Planin Vjetor të Auditimit për sezonin audituese 2022-23.

Vlora Spanca
Auditore e Përgjithshme



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE/PRANUAR/DORZUAR:			
DATE/PRILJE/DOOSTAVLJEN:			
DATE/RECEIVED/SUBMITTED: 31 10 2022			
Njësia Org. Org. Jeçin. Org. Unit	Sh. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
01	402	2225	2x24



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office



PLANI VJETOR I AUDITIMIT

1 shtator 2022 deri më 31 gusht 2023

Sezoni auditues 2022 - 2023

TABELA E PËRMBAJTJES

1. VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT.....	4
2. HYRJE.....	6
3. AUDITIMET - LLOJET DHE PROCESI I AUDITIMEVE	7
3.1. Llojet e auditimeve	7
3.2 Procesi i auditimit	9
4. OBJEKTIVAT E PLANIT VJETORE TE AUDITIMIT.....	11
4.1 Objektiv i auditimeve të rregullsisë.....	12
4.2 Objektiv i auditimeve të performancës.....	12
5.1. Buxheti	17
5.2 Burimet njerëzore dhe trajnimet	17
5. BUXHETI DHE BURIMET NJERËZORE	17
6. ZBATIMI I PLANIT VJETOR	18
A. AUDITIMET FINANCIARE DHE TË PAJTUESHMERISË.....	19
B. AUDITIMET E PERFORMANCËS.....	23

Shtojca 1. Subjektet/temat dhe vlerat që do të auditohen dhe shpërndarja e stafit.

1. VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT



Vizioni

Institucion Suprem i Auditimit i besueshëm dhe model që i shton vlerë përdorimit të fondeve publike.



Misioni

Të kryejmë auditime të pavarura, të besueshme, transparente dhe me cilësi të lartë, për të siguruar se fondet publike po përdoren kujdesshëm dhe në të mirë të qytetarëve.

Vlerat e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)



Pavarësia

Pavarësia nënkupton që i gjithë procesi i auditimit t'i nënshtrohet vetëm kërkesave të standardeve profesionale dhe të jetë jashtë ndikimit të palëve të treta. Pavarësia është elementi kryesor për të siguruar besimin e publikut dhe të Kuvendit të Kosovës, duke u ofruar atyre informacione të besueshme dhe të paanshme.



Integriteti

ZKA angazhohet për mishërimin e vlerave më të mira etike, profesionale dhe morale. Veprimtaria e auditimit kryhet në mënyrë të ndershme dhe jashtë çdo konflikti të interesit.



Profesionalizmi

ZKA udhëhiqet në veprimtarinë e saj audituese nga standardet profesionale të ONISA/INTOSAI dhe nga praktikat më të mira të vendeve.



Transparenca

ZKA është organizatë e hapur dhe do t'i bëj publike të gjitha aktivitetet e saj të rëndësishme. Po ashtu do t'i ofroj publikut të gjerë informacionin e përftuar nga auditimi, në përputhje me rregullat ligjore dhe standardet profesionale. ZKA angazhohet që të promovoj transparencën edhe në subjektet e audituara, si një element i qeverisjes së mirë.



Fryma ekipore

Në ZKA procesi i auditimit kryhet në mënyrë profesionale dhe bashkëpunuese në mes kolegëve në ekip dhe në nivele të ndryshme organizative, kështu promovojmë frymën ekipore si vlerë e shtuar për ZKA-në.

113

LLOJET E AUDITIMIT

17

3



Auditime të rregullsisë



Auditime të performancës



Auditimet të pajtueshmërisë



Buxheti i Kosovës



Institucione të nivelit qendror



Komuna



Ndërmarrje publike



Projekte të financuara nga fondet e jashtme



Auditime të performancës



Auditime të TI-së



Auditime të prokurimit



Auditimet të pajtueshmërisë

2. HYRJE

Zyra Kombëtare e Auditimit ("ZKA") si Institucion Suprem i Auditimit ("ISA") kryen auditimin e jashtëm të sektorit publik në Republikën e Kosovës. Mandati dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm janë përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës ("Ligjin e ZKA-së").

ZKA auditon Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të të gjitha organizatave buxhetore për të vlerësuar nëse ato ofrojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë dhe nëse paraja publike është shpenzuar për qëllimet për të cilat është miratuar. ZKA kryen auditime të performancës me synim të përmirësimit të shërbimeve për qytetarët dhe vlerës për para.

Sipas Ligjit të ZKA-së parashihet të hartohet Plani Vjetor i Auditimit (PVA), i cili përfshinë të gjitha aktivitetet audituese për sezonin auditues 2022/23 dhe dorëzohet tek Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP), për çdo vit deri më 31 tetor.

Në hartimin e këtij dokumenti është vepruar në përputhje me Ligjin e ZKA-së në përmbushjen e obligimeve kushtetuese e ligjore për auditime të rregullsisë.

Përzgjedhja e temave për auditime të performancës është bazuar në vlerësimin e ndikimit në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve, përmirësimin e qeverisjes dhe mundësinë që të shtoj vlerë në menaxhimin e financave publike. Si proces i rregullt në konsultime me palët e interesit dhe OJQ është vlerësuar niveli i rrezikut (qasjen e bazuar në rrezik) dhe aktualitetin e tyre. Mbi këtë bazë janë përfshirë edhe auditimet e ndërmarrjeve publike, si dhe adresimi i kërkesave specifike nga kuvendi.

Plani vjetor i auditimit përmban informatat relevante në lidhje me auditimet e përzgjedhura nga Auditorja e Përgjithshme për sezonin auditues, përfshirë projektet, aktivitetet, afatet, burimet e nevojshme, buxhetin, rezultatet dhe rreziqet që mundet të ballafaqohet ZKA.

Auditimet do të realizohen në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ("SNISA"), duke u bazuar në parimet universale të ISA-ve dhe të ZKA-së si, pavarësia, profesionalizmi, integriteti dhe transparenca. Të gjitha raportet e ZKA-së janë të qasshme për palët e interesuara dhe publikohen në faqen zyrtare të internetit.

3. AUDITIMET - LLOJET DHE PROCESI I AUDITIMEVE

Auditimi financiar dhe i pajtueshmërisë ka për qëllim rritjen e nivelit të besueshmërisë së përdoruesve të synuar të Pasqyrave Financiare dhe përdorimi i fondeve publike në pajtueshmëri me autoritetet.

3.1. Llojet e auditimeve

Në përputhje me mandatin dhe fushëveprimin e ZKA-së, gjatë sezonit 2022/23 do të kryhen këto lloje të auditimeve:



- **Auditime financiare dhe të pajtueshmërisë** të organizatave buxhetore (bazuar në sistemin e parasë së gatshme) dhe të ndërmarrjeve publike (bazuar në sistemin akrual);
- **Auditime të pajtueshmërisë**; dhe
- **Auditime të performancës**, përfshirë auditimet e teknologjisë së informacionit.

Auditimi Financiar dhe i Pajtueshmërisë: përfshinë auditimin e PFV-ve të institucionit me qëllim të vlerësimit nëse raportet janë të besueshme dhe pasqyrojnë rezultatet e realizimit të buxhetit në mënyrë të drejtë; vlerësimin nëse

menaxhmenti iu ka përmbajtur ligjeve dhe akteve nënligjore të zbatueshme dhe nëse fondet janë përdorur për qëllimet e synuara; vlerësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar, funksionet e auditimit të brendshëm dhe sistemet e kontrollit të brendshëm.

Objektivat e auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë përkufizohen si siguri e arsyeshme, e cila i ofrohet shfrytëzuesve të Pasqyrave Financiare, nëse Pasqyrat Financiare të audituara janë në tërë kuptimin material të vërteta dhe të drejta (apo të paraqitura drejtë) dhe nëse transaksionet e raportuara në ato pasqyra janë kryer në pajtueshmëri me autoritetet¹.

Auditimet financiare dhe i pajtueshmërisë kryhen për çdo vit. Procesi i auditimit fillon në shtator, ndërsa raportet e auditimit për OB-të individuale publikohen deri në fund të muajit qershor. Cikli i auditimeve përmbyllet në fund të muajit gusht kur Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës (RFV/BK) dorëzohet në Kuvendin e Kosovës.

1. "Pajtueshmëri me autoritetet" do të thotë përputhshmëri me aktet apo rezolutat e legjislaturës apo instrumente tjera statutore, direktiva dhe udhëzues të nxjerra nga organet e sektorit publik me kompetenca të përcaktuara me statut, të cilave pritet t'i përmbahet entiteti i audituara. Thënë ndryshe, është pajtueshmëri me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira.

Auditimet të pajtueshmërisë: Objektivi i auditimit të pavarur të pajtueshmërisë është t'u ofrojë përdoruesit(ëve) të synuar informacione për atë nëse entitetet publike të audituara i përmbahen vendimeve parlamentare, ligjeve, akteve legislative, politikave, kodeve të vendosura, standardeve dhe kushteve të dakorduara të kontratave dhe memorandumëve të mirëkuptimit.

Auditimi i pajtueshmërisë përfshinë si aspektet e rregullsisë (respektimi/bindja me kriteret formale siç janë ligjet, rregulloret dhe marrëveshjet përkatëse) dhe/ose konformitetit (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publikë). Pavarësisht nga burimi i kriterëve, auditori kryen auditimin dhe formon një përfundim me nivelin e zgjedhur të sigurisë, në përputhje me kërkesat në ISSAI 400 dhe 4000².




Auditimet e performancës: paraqesin një shqyrtim të pavarur, objektiv dhe të besueshëm nëse angazhimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat janë duke vepruar në përputhje me parimet e **ekonomicitetit** (minimizimi i kostove të burimeve), **efikasitetit** (përfitimi sa më shumë nga burimet në dispozicion) dhe **efektivitetit** (përmbushja e objektivave të përcaktuara dhe rezultateve të synuara).

Fushat, objektivat dhe koha e auditimit dhe e raportimit përcaktohen prej rastit në rast, duke u bazuar në rëndësinë, rrezikun, fushëveprimin e auditimit, kapacitetet ekzistuese si dhe kriteret tjera përkatëse.

Auditimi i performancës fokusohet në atë se si organizatat e sektorit publik i kanë përdorur burimet në dispozicion për t'i arritur objektivat e tyre. Për ekzaminimin e performancës së entitetit të audituar, ZKA-ja ndjek njëren nga tri qasjet:

- qasjen e orientuar në *rezultate*, e cila vlerëson nëse janë arritur objektivat e paracaktuara;
- qasjen e orientuar në *problem*, e cila verifikon dhe analizon shkaqet e problemit(ve); ose
- qasjen e orientuar në *sistem*, e cila ekzaminon funksionimin e sistemeve menaxhuese: ose një kombinim të të tri qasjeve.



Në kuadër të auditimeve të performancës përfshihen edhe Auditimet të TI-së që definohet si ekzaminim dhe rishikim i sistemeve të teknologjisë së informacionit (TI) dhe kontrollet e ndërlidhura me to, për të përfituar siguri ose për të identifikuar rreziqet lidhur me parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, ekonomikitetit dhe efektivitetit të sistemeve të TI-së dhe kontrolleve lidhur me këto sisteme.


2. Doracaku i auditimit të pajtueshmërisë (auditimi i pavarur i pajtueshmërisë).

3.2 Procesi i auditimit

A. Procesi i auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë- bazohet në metodologjinë e auditimit të përshkruar në Doracakun e Auditimit Financiar dhe të Pajtueshmërisë (Metodologjia e qasjes së kombinuar) dhe SNISA-t. Auditimi i rregullsisë kryhet nëpër disa hapa duke filluar nga: njohja e entitetit dhe analiza e rreziqeve

- planifikimi i auditimit;
- ekzekutimi i auditimit;
- dhënia e konkluzioneve dhe opinionit të auditimit;
- raportimi në Kuvend dhe informimi i opinionit publik (publikimi i raporteve); dhe
- përcjellja e adresimit të rekomandimeve të auditimit.

B. Procesi i auditimeve të performancës dhe të pajtueshmërisë- bazohet në metodologjinë e auditimit të përshkruar në Doracakun e Auditimeve të Performancës dhe SNISA-t. Auditimi i performancës dhe ai i pajtueshmërisë kanë qasje të njëjta dhe kryhet nëpër fazat në vijim:

Grafiku 1: Fazat e procesit të auditimit të performancës

Faza 1. Planifikimi. Përfshinë propozimin e temave për auditim dhe përgatitjen e memove parastudimore. Propozimet shqyrtohen përmes një procesi vlerësues lidhur me përshtatshmërinë dhe rëndësinë e temës për t'u audituar. Në këtë fazë po ashtu, ekipet e auditimit bëjnë një hulumtim më të thellë rreth temës përkatëse, ku përcaktohen: problemi i auditimit, objektivat e auditimit, motivi i auditimit, fushëveprimi i auditimit, etj.

Faza 2. Ekzekutimi i punës në terren. Ekipet e auditimit pasi që të kenë përgatitur planin detaj të punës fillojnë me kryerjen e punëve audituese në terren dhe të hartojnë draft raportin e auditimit.

Faza 3. Raportimi. Ekipi auditues përfundon hartimin e raportit të auditimit, i cili duhet të jetë objektiv, gjithëpërfshirës, i qartë për lexuesin, etj. Pasi që raporti ka kaluar nëpër kontrollin e cilësisë dhe janë dhënë aprovimet e duhura, bën publikimin e tij.

Faza 4. Përcjellja e auditimit. Pasi të ketë kaluar një periudhë e përshtatshme kohe, ZKA-ja mund të kryejë një vlerësim të progresit të entitetit të audituar në përgjigjet ndaj gjetjeve të auditimit dhe zbatimit të rekomandimeve dhe të raportoje për to përmes një auditimi përcjellës. Bazuar në standardet e auditimit si dhe në Doracakun për auditime të performancës, auditimet përcjellëse jo domosdoshmërisht kryhen për secilin auditim të kryer paraprakisht. Lidhur me auditimet përcjellëse vendoset në bazë të rëndësisë së temës.

Procesi i auditimit financiar dhe i pajtueshmërisë në ZKA monitorohet dhe rishikohet nga Departamenti për Metodologji dhe Departamenti për Sigurimin e Cilësisë, të cilat kanë përgjegjësi për të siguruar menaxhmentin që auditimet janë kryer duke u bazuar në metodologjinë e aprovuar nga Auditori i Përgjithshëm dhe në përputhje me SNISA-t.

Auditimet e performancës në ZKA janë subjekt i një sistemi të kontrollit të cilësisë duke përfshirë proceset për mbikëqyrje dhe monitorim të cilësisë, sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin profesional nga individë tjerë të kualifikuar të fushave të ngjashme. Fazat e planifikimit, ekzekutimit dhe raportimit të auditimit janë subjekt i rishikimit në të gjitha nivelet menaxheriale. Parastudimet dhe draft raporti rishikohen në mënyrë sistematike përmes rishikimeve ndër-kolegiale përpara se të shqyrtohet nga drejtori i departamentit dhe menaxhmenti i lartë. Për disa nga temat angazhohen këshilltarë të jashtëm të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë dhe në disa raste edhe ekspert të fushës.

4. OBJEKTIVAT E PLANIT VJETORE TE AUDITIMIT

Zyra Kombëtare e Auditimit planifikon punën e audituese në baza vjetore, i cili bazohet në objektivat e Planit Strategjik. Objektivat e ZKA-së për sezonin auditues 2022/23 janë përputhje me kërkesat ligjore që synohet rritjen e ndikimit në përmirësimin e qeverisjes dhe mundësinë që të shtoj vlerë në menaxhimin e financave publike.

Për sezonin e auditimit 2022/23 janë planifikuar 134 auditime, ku janë paraqitur në Tabelën 1- Plani auditues përfshin të gjitha auditimet e detyrueshme të rregullsisë të përcaktuara me nenin 18.3 të Ligjit të ZKA-së, që gjithsej 91 OB, 11 projekte të financuara nga fondet e jashtme; 11 ndërmarrje publike , 18 auditime të performancës dhe 3 auditime të pajtueshmërisë.

Tabela 1: Numri dhe lloji i auditimeve të planifikuara për sezonin e auditimit 2022/2023

Llojet e auditimit	Numri i auditimeve
Auditime të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë)³	113
○ Buxheti i Kosovës	1
○ Institucione të nivelit qendror	52
○ Komuna	38
○ Ndërmarrje publike	11
○ Projekte të financuara nga fondet e jashtme	11
Auditime të performancës⁴	18
○ Auditime të performancës	9
○ Auditime të prokurimit	5
○ Auditime të TI-së	4
Auditime të pajtueshmërisë	3
○ Auditimet të pajtueshmërisë ⁵	3
Gjithsej	134

3. Auditimi i 11 Institucioneve të pavarura dhe 6 komunave do të përkrahët nga një kompani private e auditimit.

4. Për temat e zgjedhura të auditimit të performancës, së pari do të kryhen parastudimet dhe pastaj do të vendoset për auditimin e tyre.


5. Auditimi i të hyrave nga qiraja në AKP dhe dy auditime për informata të kalsifikuar (MB-MD).

Të gjitha auditimet janë paraqitur në **Shtojcën 1** të këtij dokumenti.

Raportet individuale për auditimet e rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë) do të finalizohen deri më 30 Qershor 2023, si dhe në përputhjen me afatin ligjor, Raporti Vjetor i Auditimit për Buxhetin e Kosovës pritet t'i dorëzohet Kuvendit të Kosovës jo më vonë se 31 gusht të vitit 2023. Ndërsa, auditimet e performancës dhe të projekteve do të publikohen sipas kalendarit kohor të përcaktuar dhe aprovuar nga Auditori i Përgjithshëm.

Angazhimi i burimeve njerëzore është bërë duke marrë parasysh: disponueshmërinë me burime njerëzore si dhe kualifikimin dhe përvojën e stafit; madhësinë e buxhetit që auditohet, rrezikshmërinë dhe kompleksitetin e temës audituese; si dhe bazuar në përvojën nga vitet paraprake.

4.1 Objektivi i auditimeve të rregullsisë



Për dallim nga sezoni i kaluar, përveç auditimeve të rregullta vjetore, menaxhmenti i ZKA-së ka vendosur të kryejë auditimin financiar dhe të pajtueshmërisë për Korporata Energjetike e Kosovës, sh.a (KEK) për herë të parë nga ekipet e ZKA-së. Ndërsa, duhet të theksohet se krahasim me vitin e kaluar kemi zvogëluar kontraktimin e Institucione të Pavarura prej 8-sosh (prej 19 sa ishin, tani janë 11 të kontraktuara).

Gjithsej auditimi i 11 institucioneve të pavarura dhe gjashtë komunave do të përkrahet nga një kompani private e auditimit, përderisa opinioni i auditimit përcaktohet nga Auditori i Përgjithshëm bazuar në metodologjinë e ZKA-së dhe në përputhje me SNISA-t.

Për sezonin auditues 2022/23, ZKA-ja ka planifikuar auditimin e rregullsisë 90 OB (financiar dhe të pajtueshmërisë pa përfshirjen e RVA-së), 11 auditime të NP, si dhe 11 projekteve të financuara nga donatorët. Prej të cilave, 10 projekte të financuara nga Banka Botërore dhe 1 projekte të financuara nga Agjencioni Suedez për Zhvillim (Sida). Vlen të theksohet se ZKA ka krijuar mekanizma të brendshëm në trajtimin e kërkesave të ndryshme që vijën nga palët e jashtme për auditime me kërkesë, dhe si të tilla janë trajtuar në mënyrën efektive.

4.2 Objektivi i auditimeve të performancës

Për sezonin auditues 2022-2023 do të mbulohen fusha me rëndësi ekonomike, sociale, shëndetësi, arsim, media, kulturë e sport si dhe tema të rëndësishme në fushën e prokurimit publik dhe projekteve nga donatore, po ashtu janë planifikuar auditime të sistemeve të informacionit.

Mënyra e përzgjedhjes së auditimeve të performancës- Me qëllim të maksimizimit të burimeve dhe rritjes së ndikimit përmes këtyre auditimeve në mirëqenien e qytetarëve, ZKA zhvillon një proces deri të përzgjedhjes së fushave/temave të auditimit. Fillimisht identifikohen fushat kryesore, pastaj analizohen raportet e auditimit të rregullsisë (financiare dhe pajtueshmërisë) për identifikimin e mangësive kyçe si dhe ftohen auditorët të propozojnë tema bazuar në njohuritë e tyre dhe problematikat e hasura gjatë auditimeve paraprake.

Për më shumë, ka zhvilluar tryezë të përbashkët me Shoqërinë Civile si OJQ, organizata profesionale, komuniteti i donatoreve dhe ekspertë të fushave, për diskutimin e temave dhe kemi dhënë mundësinë pjesëmarrësve për ofrimin e propozimeve. Si rrjedhojë, në planin e auditimit për sezonin 2022-2023 janë përfshirë tema të propozuara nga shoqëria civile, me kërkesë nga Kuvendi i Kosovës, si dhe projekte të donatorëve.

Gjatë vitit 2022, ZKA ka praktikuar mekanizimin e pranimit të raportimeve të ndryshme nga palët e jashtëm, theks të veçantë nga qytetarët e Kosovës që kanë shprehur shqetësimet e tyre për mbarëvajtjen e projekteve të financuara nga buxheti i shtetit që ndërlidhen me menaxhimin e financave publike në ambientet ku jetojnë dhe veprojnë. Në përgatitjen e planit vjetor nga ZKA, këto shkresa janë trajtuar me seriozitet duke i analizuar gjitha elementet/indikacionet e raportuar nga qytetarët, prandaj vlen të theksohet se një temat e auditimit të performancës në këtë vit është rezultat i raportimit nga qytetarët.

Përmes këtyre auditimeve, ZKA synon të promovojë efikasitetin, llogaridhënien, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike.

Po ashtu gjatë përzgjedhjes së fushave që do të mbulohen me auditimet e performancës, prokurimit dhe TI-së janë marrë parasysh edhe qëllimet e Agjendës së Kombeve të Bashkuara për zhvillim të vazhdueshëm 2030.

Qëllimi: Sigurimi i jetëve të shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjitha moshat.



Shëndetësia: Shëndetësia ka rol të rëndësishëm në jetën e secilit qytetar. Për të ofruar shërbime mjekësore adekuate dhe në kohë institucionet përgjegjëse duhet të sigurojnë infrastrukturën fizike dhe staf profesional. Shërbimet mjekësore që ofrohen nga institucionet shëndetësore publike vazhdojnë të kenë sfida e që kjo ndikon në krijimin e listave të gjata të pritjes për qytetarët që drejtohen për trajtim në spitale publike. Për shkak të mos mirëmbajtjes dhe menaxhimit të pajisjeve si CT, MRI, etj, pacientet nuk mund të marrin shërbimet e nevojshme. Qëllimi i këtij auditimi do të jetë të vlerësojmë mënyrën e menaxhimit të listave të pritjes së pacientëve në institucionet shëndetësore publike dhe ndikimi i saj në rrezikun e shëndetit të pacientëve.



Kulturë dhe sport: Sporti është komponentë i rëndësishëm i zhvillimit socio-ekonomik të një vendi. Pjesëmarrja aktive në sport përmirëson shëndetin dhe produktivitetin e komunitetit, zvogëlon shpenzimet mjekësore, gjeneron liderë të mëdhenj dhe rrit kohezionin social. Sipas ligjit për sponsorizimin e sportit të dekretuar në vitin 2017, parashihet se bizneset kanë mundësi të financojnë aktivitetet sportive për interes të përgjithshëm për përmirësimin e jetës së qytetarit, në anën tjetër bizneset që financojnë aktivitetet e sportit i lejohej zbritja deri në shumën 30% të tatimit në fitim. Shoqëria civile ka propozuar këtë temë për shkak të dyshimeve lidhur me financimin e tyre nga ana e bizneseve dhe se klubet sportive dhe bizneset nuk përmbushin kërkesat e parapara në ligj. Bazuar në vlerësimet e bëra ZKA e konsideron si temë me rëndësi për auditim.

Në raportet financiare të ZKA-se është raportuar për parregullsi të ndryshme në këtë fushë, si; mos raportim të saktë nga ana e federatave të sportit, mos arsyetim të projekteve me kohe dhe sipas rregullores, arsyetim i dobët i shpenzimeve nga ana e federatave etj. Qëllimi i këtij auditimi do të jetë të vlerësojmë se sa kanë arritur federatat dhe klubet e sportit në Kosovë ti plotësojnë objektivat e tyre të financuara nga ana e bizneseve dhe ministrisë përkatëse.

Qëllimi: Sigurimi i arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës



Arsimi: Akreditimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë është pjesë e rëndësishme për të siguruar se këto institucione kryejnë punën e tyre në pajtim me standardet e kërkuara të vendosura në vend. Mënyra e akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë mbetet sfida nëse janë duke arritur të bëhet kjo për të siguruar cilësi të lartë. Qëllimi i këtij auditimi do të jetë vlerësimi nëse Agjencia Kosovare e Akreditimit, përmes mekanizmave të vendosur është duke akredituar Institucionet e Arsimit të Lartë sipas standardeve, vlerësim profesional dhe transparent, si dhe se janë duke punuar në pajtim me kriteret.

Qëllimi: Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave



Mirëqenia sociale: Dhuna në familje paraqet shkelje të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. Dhuna në familje në Republikën e Kosovës mbetet një ndër problemet më serioze me të cilat përballet shoqëria. Problemi i dhunës në familje është diskutuar shumë në mediat e shkruara dhe elektronike, në raporte hulumtuese të organizatave të shoqërisë civile, në raportin e Progresit etj. Në disa raste, dhuna në familje mund të jetë edhe me pasoja fatale. Rritja e numrit të rasteve me fatalitet, si pasojë e mos veprimit me kohë të institucioneve përgjegjëse për rastet e raportuara të dhunës

në familje, identifikohet si fushë me interes të veçantë për auditim. Qëllimi i këtij auditimi është që të vlerësojmë se çfarë veprimesh kanë ndërmarrë Institucionet e Republikës së Kosovës për parandalimin, mbrojtjen, ri-integrimin dhe fuqizimin e viktimave të dhunës në familje, si dhe për ndëshkimin dhe rehabilitimin e kryerësve të dhunës përmes trajtimit psiko-social.

Qëllimi: Sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimi i qëndrueshëm i ujit dhe kanalizimeve për të gjithë



Zhvillimi Ekonomik: Uji është njëri nga elementet kryesore dhe vitale për të gjithë format e jetës e po ashtu edhe për jetën e njeriut. Shumica e vendeve në botë edhe në Kosovë e rregullojnë furnizimin me ujë përmes kompanive shërbyese të ujit. Në vendin tonë vetëm 79% e popullatës sigurohet me ujë të pijshëm dhe të sigurtë përmes Kompanive Rajonale të Ujësjellësit (KRU). Problemet me furnizim me ujë në KRU-të janë të natyrave të ndryshme duke filluar nga humbjet për shkak të rrjedhave në rrjetin e shpërndarjes para njehsorit dhe si rrjedhat në rezervat e ujit të pijshëm, gabimet vlerësimet në matje, konsum i pa autorizuar etj.

Krahas kësaj nëpër KRU-të përgjatë viteve janë realizuar investime kapitale afërsisht në vlerë prej 6.000.000 € deri në vitin 2020 me qëllim të përmirësimit të furnizimit me ujë për qytetarët.


Në këtë vit, ZKA do të kryej auditimin e Autoriteti Rregullativ të Ujit dhe koordinimin me KRU-të rajonale sipas kërkesës së Kuvendit. Qëllimi i këtij auditimi do të jetë vlerësimi i duhur i nevojave dhe planifikimi i duhur për të realizuar investimet kapitale me qëllim të zvogëlimit të humbjeve të ujit dhe rritjes së furnizimit.

Qëllimi: Promovimi i rritjes ekonomike dhe gjithëpërfshirëse, punësim i plotë dhe produktiv për të gjithë

Auditimi i KIESA-NVM. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të një vendi. Këto ndërmarrje tejkalojnë në mënyrë të konsiderueshme firmat e mëdha me numër më të madh të të punësuarve dhe sjellje me të mëdha të inovacioneve.

NVM-të në vendet Evropiane konsiderohen si shtylla kurrizore e ekonomisë të cilat ofrojnë punë dhe mundësi rritje. Por pas kufizimeve të COVID 19 ato mund të jenë me të prekurat nga ngadalësimi i zhvillimit ekonomik. Në anën tjetër ka indikacione që Agjencinë Për Përkrahjen e Ndërmarrjeve (KIESA) dhe për tërheqjen e investimeve është shumë prapa në planifikim, si dhe në mungesë të politikave koherente për zhvillim të tyre.

Gjatë periudhës së pandemisë numri i bizneseve të cilat ishin mbyllur në krahasim me periudhën para pandemisë ishte më i madh. Sfidat të cilat po kalojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme pas periudhës së pandemisë është i madh siç janë; mungesa e energjisë elektrike, probleme me furnizime me lënde të parë, vështirësi në qasje në kredi, norma të larta të interesit etj. Ky auditim do të ketë për qëllim/objektiv: “Mbështetja e investimeve në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme nga KIESA”.



Mediat: Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere pas shqyrtimit të Raportit vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2021 ka mbajtur një takim dhe me shumicë votash ka kërkuar nga ZKA që të realizoj auditimin e performancës së Komisionit të Pavarur për Media në sezonën audituese 2022/2023. Ky auditim do të përfshijë periudhën audituese për vitet 2008-2022 për licencat e lëshuara nga Komisioni për Mediat në vend.

Fusha e medias është përfshirë në plan vjetor si fushe më rëndësi kombëtare dhe sipas kërkesës së komisionit përkatës në Kuvend.

Qëllimi: Sigurimi i modeleve të qëndrueshme (Promovimi i praktikave të qëndrueshme të prokurimit publik)




Prokurimi publik. Përmes prokurimit publik, në vitin 2021, janë lidhur 9,892 kontrata në vlerë mbi 429.6 milion euro. Gjithsej 160 autoritete kontraktuese (AK) ishin përfshirë në zhvillimin e këtyre aktiviteteve të prokurimit. Pra 7,175 kontrata janë nënshkruar nga organizatat buxhetore, ndërsa 2,712 sosh i kanë nënshkruar ndërmarrjet publike. Agjencia Qendrore e Prokurimit nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet të prokurimit gjatë vitit 2021.

Auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë, si dhe ato të performancës për prokurim publik të kryera gjatë viteve paraprake kanë nxjerrë në pah një sërë mangësish në zhvillimin dhe zbatimin e procedurave në të gjitha fazat e prokurimit, nisur nga planifikimi, zhvillimi i procedurave, menaxhimi i kontratave dhe deri në finalizimin e projektit apo pranimin e punëve.

Për sezonin auditues 2022/2023, ZKA-ja ka planifikuar auditimin e kontratave të lidhura me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Rinovimi dhe ri-konfigurimi i Stadiumit të qytetit në Mitrovicë, Gjilan dhe Gjakovë; Efektiviteti dhe ekonomia në ndërtimin e shtëpive për të kthyerit (riatdhesimi); Projektet e financuara nga grantet e DEMOS për vitin 2021 si dhe kontratat e institucioneve publike të Republikës së Kosovës me organizatën Caritas Kosova. Po ashtu do të kryhet një auditim përcjellës i zbatimit të rekomandimeve në raportet e publikuara në vitin 2018.

Qëllimi i këtyre auditimeve është të shqyrtojmë fazat e projektit që nga planifikimi, zhvillimi i procedurave të prokurimit, menaxhimi i kontratës, deri në vënien e tyre në shfrytëzim për qytetarët. Rrjedhimisht, do vlerësojmë se sa të dobishme janë për qytetarët investimet që i kanë bërë autoritetit kontraktuese dhe sa kanë arritur ato vlerë për paranë e investuar.

Qëllimi: Forcimi i mjeteve të zbatimit dhe rigjallërimi i Partneritetit Global për Zhvillim të Qëndrueshëm, pjesa e teknologjisë



Teknologjia e Informacionit (TI). Auditimet e TI-së po ashtu kontribuojnë në disa nga Qëllimet e vendosura në agjendën për zhvillim. Zhvillimi i vazhdueshëm i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ka bërë të mundur ruajtjen, procesimin dhe ofrimin e informacioneve në mënyrë elektronike. Me rritjen e aplikimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit është rritur edhe rëndësia dhe nevoja e auditimeve të TI-së. Këto auditime janë një ekzaminim dhe rishikim i sistemeve të teknologjisë së informacionit

dhe kontrolleve përkatëse për të pasur siguri mbi parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, ekonomisë, dhe efektivitetit të sistemeve të informacionit. ZKA i ka kushtuar rëndësi të veçantë auditimeve të teknologjisë së informacionit pasi në përgjithësi ka dobësi në këtë fushë dhe institucionet përgjegjëse kanë nevojë për përmirësime në qeverisjen dhe sigurinë e sistemeve të informacionit si dhe në efikasitetin e përdorimit dhe menaxhimit të këtyre sistemeve.

Për sezonin auditues 2022/2023 janë planifikuar katër auditime në fushën e teknologjisë së informacionit, "Sistemet e TI-së në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit/MPB", "Sistemet e Informacionit në Kompaninë e Ujësjellësit Rajonal Prishtina", "Sistemi E-prokurimi" dhe "Menaxhimi i sistemeve të informacionit në Institutin Bujqësor të Kosovës/MBPZHR".

Qëllimi i këtyre auditimeve është planifikimi dhe menaxhimi i projekteve/sistemeve të TIK, vlerësimi i kontrolleve të aplikacionit, siguria e informacionit dhe transparenca. Njëkohësisht do të vlerësohet përdorimi i sistemeve dhe efikasiteti i aktiviteteve/proceseve të zhvilluara përmes sistemeve të informacionit.


5. BUXHETI DHE BURIMET NJERËZORE

5.1. Buxheti

ZKA-ja është institucion i pavarur, i cili financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës i cili miratohet nga Kuvendi i Kosovës, sipas procedurës së përcaktuar me Ligjin 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Buxheti menaxhohet dhe shpenzohet me një përgjegjësi dhe llogaridhënie të lartë.

Bazuar në Ligjin e Buxhetit për vitin 2022, mjetet e ndara për ZKA-në ishin në shumë prej 3,066,355€. Krahasuar me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2021, buxheti për vitin 2022 shënon një rritje rreth 10%. Buxheti ishte i ndarë në katër kategori ekonomike: Paga dhe mëditje, Mallra dhe shërbime, Shërbime komunale dhe Investime kapitale.

Me ndarjen e miratuar buxhetore për vitin 2022, ZKA-ja ka ndryshime në numrin e punonjësve përshtatë sosh më shumë është aprovuar por nuk është ndarë buxhet për këto pozita, por bazuar në kërkesat për auditimeve dhe rritjes së portofolit të auditimeve nuk janë të mjaftueshme për ti mbuluar gjithë këto auditime. Kjo e vështirëson përmbushjen e objektivave institucionale për përfshirjen e të gjitha organizatave buxhetore në auditimin financiar dhe të pajtueshmërisë, pastaj përfshirjen në auditimin e rregullsisë të më shumë ndërmarrjeve publike si dhe rritjen e numrit të auditimeve të performancës. Në mungesë të burimeve të mjaftueshme, ZKA-ja është e detyruar për çdo vit të kontrakttoj një kompani private të auditimit për të përkrahur auditimin e një numri të caktuar të organizatave buxhetore, për kundër faktit që këtë vit kemi zvogëluar numrin e auditimeve të kontraktuara.



5.2 Burimet njerëzore dhe trajnimet

ZKA me buxhetin vjetor ka të miratuar 180 vende pune, mirëpo aktualisht ka të punësuar 168 punonjës. Numri prej 132 punonjësve janë të angazhuar drejtpërdrejt në auditim, kurse pjesa tjetër në shërbimet tjera menaxheriale, administrative dhe mbështetëse. Struktura kualifikuese e punonjësve auditues është e nivelit të lartë dhe në proces të përmirësimit të vazhdueshëm.

Për të arritur qëllimet dhe objektivat strategjike, ZKA-ja është duke investuar në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të burimeve njerëzore. Punonjësve auditues do t'iu mundësohet vijimi i trajnimeve dhe arritja e normativit të përcaktuar me SNISA-t për arsimin e vazhdueshëm profesional, si një nga faktorët themelor për kryerjen e auditimeve me kompetencë, cilësi dhe sipas kërkesave të SNISA-ve.

Sipas planit vjetor të trajnimeve, mbahen trajnime të rregullta me tema në interes për auditorët që kryesisht në muajt (shtator/ janar) kur auditorët kanë më pak angazhime në procesin e auditimit. Trajnimet mbahen nga ekspertët e ZKA-së dhe ata të jashtëm, pastaj një numër i konsiderueshëm i punonjësve përfitojnë trajnime nga partnerët e jashtëm si, Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë dhe shoqatat profesionale për auditim dhe kontabilitet.

Me organizimin e trajnimeve do të vazhdohet edhe për sezonin e auditimit 2022/23. ZKA-ja (dep. i Metodologjisë dhe dep. për Buxhet dhe Burime Njerëzore) harton planin vjetor të trajnimeve që përfshinë trajnime nga personeli i ZKA-së dhe ekspertë të jashtëm. Përmbajtja e trajnimeve dhe mënyra e organizimit të tyre do të adaptohet në funksion të zbatimit të objektivave strategjike të institucionit.

6. ZBATIMI I PLANIT VJETOR

Plani vjetor i auditimit do të zbatohet nga 1 shtatori 2022 deri më 31 gusht 2023.

Zbatimi i aktiviteteve të planifikuara në këtë plan, bëhet përmes planeve operative audituese, sipas fushave, organizatave buxhetore dhe projekteve të caktuara, shumave të buxhetit, afatet kohore, si dhe përbërjen e stafit që do e kryen realizimin e planit në këtë sezonë audituese, duke mbështetur nga sistemi informativ i teknologjisë së kryerjes së auditimit-SITA.

Prishtinë, Tetor 2022

Vlora Spanca
Auditore e Përgjithshme

Shtojca 1. Subjektet/temat dhe vlera e buxhetit që do të auditohet.

A. AUDITIMET FINANCIARE DHE TË PAJTUESHMERISË

Tabela 2: Institucione të nivelit qendror [1 + 52 = 53]

	Entitetet nën auditim	Buxheti 2022
1	Auditimi i Raportit Vjetor të Buxhetit të Republikës së Kosovës	2,552,927,727
2	Kuvendi i Kosovës	9,674,105
3	Zyra e Presidentit	3,648,015
4	Zyra e Kryeministrit	16,189,275
5	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	838,157,987
6	Administrata Tatimore e Kosovës	13,257,788
7	Dogana e Kosovës	11,520,664
8	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	6,652,075
9	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	69,137,141
10	Ministria e Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë	14,988,335
11	Ministria e Ekonomisë	32,454,375
12	Ministria e Shëndetësisë	56,793,320
13	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	129,616,523
14	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore	8,162,998
15	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	39,159,109
16	Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Teknologjisë	73,086,831
17	Universiteti i Prishtinës	32,176,344
18	Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit	4,382,895
19	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	186,673,730
20	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës	172,575,374
21	Ministria e Drejtësisë	29,621,039
22	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	38,482,606
23	Ministria e Mbrojtjes	102,305,450
24	Ministria e Zhvillimit Rajonal	4,213,901
25	Këshilli Prokurorial i Kosovës	17,144,178
26	Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve	1,429,937
27	Këshilli Gjygjësor i Kosovës	32,133,896

28	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik*	714,399
29	Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës*	1,137,180
30	Autoriteti i Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	1,376,100
31	Agjencioni Kundër-Korrupsion*	545,778
32	Zyra Rregullatorit për Energji	953,660
33	Organi Shqyrtues i Prokurimit*	418,346
34	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas*	443,995
35	Gjykata Kushtetuese e Kosovës	2,081,273
36	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës*	344,996
37	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore*	220,873
38	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa*	215,281
39	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës*	371,132
40	Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit*	371,083
41	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	351,789
42	Autoriteti i Aviacionit Civil	1,004,947
43	Komisioni i Pavarur i Mediave	1,028,065
44	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	5,913,951
45	Institucioni i Avokatit të Popullit	1,282,766
46	Akademia e Drejtësisë*	660,149
47	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	2,568,332
48	Agjensioni për Informim dhe Privatësi*	420,850
49	Agjencioni për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale	5,811,432
50	Fondet në Mirëbesim	-----
51	Agjencioni Kosovar i Privatizimit	5,533,002
52	Agjencioni për Shërbimet e Navigimit Ajror	6,232,438
53	Radio Televizioni i Kosovës	8,960,000

*Institucionet e Pavarura, auditimi i së cilave do të përkrahet nga kompania private e auditimit.

Tabela 3: Komuna [38]

	Entitetet nën auditim	Buxheti 2022
1	Prishtinë	90,669,333
2	Obiliq	11,822,169
3	Podujevë	22,728,357
4	Fushë Kosovë	11,656,080
5	Mitrovica e Jugut	20,725,819
6	Graçanicë	7,542,020
7	Mitrovica e Veriut	5,362,984
8	Zubin Potok*	2,533,005
9	Zveçan*	2,315,188
10	Prizren	47,788,686
11	Mamusha*	1,802,040
12	Malishevë	14,900,757
13	Rahovec	15,053,659
14	Lipjan	17,593,652
15	Shtime	7,704,029
16	Suharekë	16,334,504
17	Shtërpçë	3,871,348
18	Kllokot	1,145,364
19	Gjilan	29,075,278
20	Viti	13,069,495
21	Novobërdë	2,912,680
22	Ferizaj	33,933,868
23	Klinë	11,333,332
24	Pejë	29,296,054
25	Istog	11,611,999

26	Glllogoc	15,846,091
27	Skenderaj	14,528,788
28	Vushtrri	18,878,129
29	Gjakovë	26,330,580
30	Deçan	10,649,355
31	Dragash*	9,329,477
32	Junik*	1,658,591
33	Kamenicë	11,070,591
34	Leposaviq*	4,602,915
35	Partesh	1,129,456
36	Ranillug	1,569,421
37	Kaçanik	9,193,167
38	Hani i Elezit	2,759,758

*Institucionet lokale, auditimi i së cilave do të përkrahet nga kompania private e auditimit.

Tabela 4: Ndërmarrje publike [11]

	Entitetet nën auditim	
1	Korporata Energjetike e Kosovës, sh.a (KEK)	
2	Hekurudhat e Kosovës - InfraKos, sh.a	
3	Hekurudhat e Kosovës - TrainKos, sh.a	
4	KRU "Prishtina" sh.a - Prishtinë	
5	Ndërmarrja Publike Banesore - Prishtinë	
6	Telekomi i Kosovës	
7	Posta e Kosovës	
8	KRM "Pastrimi", sh. a - Prishtinë	
9	KRM " Uniteti" sh.a - Mitrovicë	
10	Ngrohtorja Qendrore "Termokos" - Prishtinë	
11	NPH "Ibër - Lepenc" sh.a - Prishtinë	

Tabela 5: Projekte që financohen nga huamarrja shtetërore dhe nga donatorët [11]

	Entitetet nën auditim
1	Konkurrueshmëria dhe gatishmëria për eksport (MTI - BB)
2	Efiçienca e Energjisë së ripërtritshme -konsolidim(MZHE - BB)
3	Zhvillimi Rural dhe Agrobujqësor (MBPZHR - BB)
4	Ekonomia Digjitale në Kosovë (MEA - BB)
5	Projekti i emergjencës Covid-19 në Kosovë (MSH - BB)+1
6	Pasuria e paluajtshme & infrastruktura gjeohapësinore (Agjencia Kadastrale e Kosovës - BB)
7	Projekti "Komunat për rininë në Kosovë" (MAPL - BB)
8	Programi Mjedisor i Kosovës (MMPH - SIDA)
9	Projekti „Reformën në sistemin e Asistencës Sociale“. (2 projekte) BB
10	Projekti “ Prog. shfrytëzimi dhe nxitjen e mundësive për sigurinë e ujit „ BB
11	Projekti “ Prog. shfrytëzimi dhe nxitjen e mundësive për sigurinë e ujit „ BB

B. AUDITIMET E PERFORMANCËS


Tabela 6: Temat e auditimeve të performancës [18]

	Temat nën auditim
1	Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje
2	Lista e pritjes së pacienteve në ISHP
3	Procesi i Akreditimit të Institucioneve të Larta Arsimore
4	Ndikimi investimeve kapitale në zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe përmirësimin e shërbimeve në KRU.
5	Menaxhimi i licencimeve ne Komisionin e Pavarur për Media
6	Mbështetja e ndërmarrjeve te vogla dhe të mesme-MTI/KIESA
7	Efektiviteti i fondeve për sponsorizimin e sportit
8	Kontratat e lidhura me procedure të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë/ MMPHI
9	Rinovimi dhe rikonfigurimi i Stadiumit të qytetit në Mitrovicë, Gjilanit dhe Gjakovës

10	Efektiviteti dhe ekonomia në ndërtimin e shtëpive për të kthyerit (riatdhesimit)
11	Projektet e financuara nga grantet e DEMOS për vitin 2021
12	Kontratat e institucioneve publike të Republikës së Kosovës me organizatën Caritas Kosova
13	Auditimi përcjellës i zbatimit të rekomandimeve
14	Performanca financiare dhe operative e Trepces
Auditime në fushën e teknologjisë së informacionit	
1	Sistemet e informacionit në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit MPB.
2	Sistemet e Informacionit në Kompaninë e Ujësjetës Rajonal /Prishtina.
3	E-prokurimi.
4	Menaxhimi i sistemeve të informacionit në Institutin Bujqësor të Kosovës /MBPZHR.

Tabela 7: Temat e auditimeve të pajtueshmërisë dhe të pa përfunduara [3]

Auditim e pajtueshmërisë/ kërkesë	
1	Të hyrat nga qiraja në Agjencinë Kosovare të Privatizimit
2	Informatat e klasifikuara “ e KUFIZUAR “ Ministria e Mbrojtjes
3	Informatat e klasifikuara “ e KUFIZUAR” Ministria e Drejtësisë



Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës

